

ANILA OMARI

**“DIALEKTET E GJUHËS SHQIPE” – SINTEZË E PUNËS
KËRKIMORE-SHKENCORE TË JORGJI GJINARIT**

Kur në vitin 1952 diskutohej në Institutin e Gjuhësisë për çështjen e gjuhës së përbashkët letrare shqipe, një problem i rëndësishëm që u ngrit ishte mosnjohja e dialekteve të shqipes. “Si do të vëmë njërin apo tjetrin kryedialekt në bazë të gjuhës sonë letrare kur nuk njohim mirë as njërin e as tjetrin” pyeste në formë problemore Çabej në sesion shkencor¹.

Pra deri në fillim të viteve '50 hulumtimi i dialekteve të shqipes ishte bërë në mënyrë të izoluar e sporadike dhe shkalla e njohjes së tyre ishte sipërfaqësore dhe në vija të përgjithshme.

Nevoja për t'i dhënë një shtysë studimeve dialektologjike dilte si rrjedhojë e dy çështjeve themelore që shtroheshin para gjuhësisë shqiptare në atë kohë: thellimi i studimeve për historinë e gjuhës shqipe dhe formimi i gjuhës letrare kombëtare shqipe. Për të dyja këto fusha studimi i dialekteve do të sillte të dhëna të çmuara, qoftë si ndihmë për gjurmimin e fazave më të hershme të saj në rrethanat kur gjuha shqipe kishte mangësi në dëshmi të shkruara, qoftë për bazën dialektore të shqipes letrare dhe bashkëveprimin ndër-dialektor.

Pas 30 vjetësh gjendja ndryshon rrënjësisht. Krejt hapësira shqiptare, brenda dhe jashtë kufijve, eksplorohet në mënyrë të organizuar dhe sistematike dhe përshkrimi i thujtë të gjitha të folmeve të shqipes mbulohet me monografi të veçanta. Pikat e hulumtuara në terren janë më shumë se 300 dhe studimet dialektologjike që përshkruajnë të folmet e veçanta ose grupet e të folmeve janë më shumë se 70². E gjithë kjo punë gjigante, të cilën gjuhëtari shqiptar që jetoi jashtë vendit, Namik Resuli, e quan “vepër madhështore”³, dhe që vështirë se haset me këtë denduri në gjuhët e tjera⁴, u bë e mundur falë punës këmbëngulëse e të palodhur të dialektologëve, kryesisht shqiptarë por edhe të huaj, ndër të cilët spikat emri i Jorgji Gjinarit.

¹ Khs. R. Ismajli, “Në gjuhë” dhe “për gjuhën” (rrjedha të planifikimit të shqipes në Kosovë (1945-1968), Dukagjini, 1998, f. 110-111.

² J. Gjinar, *Dialektet e gjuhës shqipe*, ASHSH IGJL, Tiranë, 1989, f. 10.

³ N. Ressuli, *I più antichi testi albanesi*, 1978, f. 18.

⁴ “...rrallë mund të gjesh për ndonjë gjuhë tjetër një rrjet jo më të dendur, por as po aq të dendur hulumtimesh dhe përshkrimesh të degëzimeve dialektore”, M. Domi, *Gjendja, probleme dhe detyra të dialektologjisë shqiptare në fazën e sotme*, “Dialektologjia shqiptare”, IV, 1982, f. 4.

Që në fillimet e punës së tij dialektologu i ri ndërmoi hulumtimin e një vargu të folmesh, në fillim të toskërishtes veriore, e njohur më mirë prej tij si nëndialekt amtar, pastaj edhe të gegërishtes, në tre nga pikat përfaqësuese të nëndarjeve kryesore të saj: Krasniqe-Gash-Bytyç për gegërishten verilindore, Bregu i Bunës për geg. veriperëndimore dhe malësi e Krujës për gegërishten qendrore. Me këtë bagazh të gjerë njohurish për dialektet e shqipes në bazë të kërkimeve vetjake dhe të kolegëve, ai arriti të hartojë së pari tekstin universitar “Dialektologjia shqiptare”. Veprat themelore dialektologjike që citohen në fund të viteve ’70 për gjuhën shqipe janë “Gjuha shqipe dhe dialektet e saj” e A. Desnickajës dhe “Dialektologjia shqiptare” e J. Gjinarit.

Një hap i rëndësishëm në studimin e dialekteve të shqipes ishte përpjekja për përcaktimin e ndarjes dialektore të shqipes, deri atëhere e dhënë nga disa albanologë të huaj në vija të përgjithshme. Këtu vlen të përmendet vlerësimi i Eric Hampit, dekanit të albanologjisë perëndimore në kohën e sotme, pikërisht për këtë çështje: “Trajtimi me siguri më i rëndësishëm, më autoritativ dhe më sistematik nga këndvështrimi i metodologjisë, i problemit të përcaktimit të dialekteve e i klasifikimit të tyre është bërë nga Gjinari (1966)⁵ (Essai d’une démarcation dialectale de la langue albanaise, Studia Albanica, 1966/3, f. 31-50)”. Klasifikimi i përcaktuar nga Gjinari, sipas tij, u ndoq edhe nga Desnickaja (1968b)⁶.

Me përfundimin e fazës përshkruese të të folmeve e dialekteve të shqipes, dilte nevoja e thellimit të mëtejshëm të studimit në dy drejtime: nga njëra anë në shpjegimin e shkaqeve të dukurive të veçanta dialektore dhe nga ana tjetër në një përgjithësim më të madh të dukurive dialektore për të nxjerrë në pah tiparet e përbashkëta të dialekteve të shqipes dhe për të vënë më mirë në dukje njësinë e gjuhës shqipe. Një kërkesë të tillë përballon Jorgji Gjinari në disertacionin e tij të doktoratës mbi dialektet e shqipes, një punë që u finalizua më pas në librin “Dialektet e gjuhës shqipe”, botuar në vitin 1989. Ky punim ishte një përgjithësim i punës së kryer deri atëhere në hulumtimin e dialekteve të shqipes si nga vetë autori ashtu dhe nga dialektologët e tjerë dhe njëkohësisht një sintezë e punës së tij kërkimore-shkencore të deriatëhershme.

Kjo vepër shënoi një hop cilësor në studimin e dialekteve të shqipes, pasi zbatonte një metodë të re për atë kohë në studimet sinkronike të shqipes, metodën strukturore-funksionale të Shkollës së Pragës, e cila filloi të zbatohej në Shqipëri në vitet ’70. Sipas kësaj metode, në punim çdo veçori fonetike

⁵ Eric Hamp, në: “Albanian, Current Trends in Linguistics”, ed. Th. A. Sebeok, vol. 9. Linguistics in Western Europe, Mouton, The Hague-Paris, 1972. Part two: The Study of Languages. Albanian, f. 1626-1629, sipas botimit shqip E. Hamp, *Studime krahasuese për shqipen*, përg. dhe red. R. Ismajli, ASHAK, Prishtinë, 2007, f. 45.

⁶ Po aty, f. 51.

dialektore shihet në sistem dhe analizohet nga aspekti strukturor e funksional, duke u parë vlera e tyre funksionale brenda sistemeve përkatëse dialektore. Tiparet dalluese të dialekteve në këtë mënyrë nuk shihen të shkëputura dhe në vetvete por grupohen sipas rëndësisë funksionale në sistem, nëpërmjet një shkallëzimi që dallon tiparet më thelbësore për sistemin e gjuhës nga ato më pak thelbësore. Të njëjtën metodë strukturaliste autori i punimit e ka zbatuar edhe në studimin e dallimeve morfologjike të dialekteve të shqipes, një punë prej pionieri në studimet tona gramatikore. Kështu, kjo analizë, duke përvijuar hapësirat dialektore me tipare të njëjta në bazë të strukturës dhe funksionit të tyre, i nxjerr ato më të gjera sesa analizat e mëparshme thjesht përshkruese të cilat jepnin një tablo të copëzuar dialektore, me ndryshime më të shumta nga ana numerike. Për procesin e formimit të gjuhës së njësuar letrare shqipe, që prej pak vitesh ishte sanksionuar në Kongresin e 1972-shit, kjo analizë kishte rëndësi për të vënë në dukje tiparet e përbashkëta të dialekteve të shqipes, bazën e përbashkët të tyre që ishte në themel të gjuhës letrare shqipe dhe që dilte më e gjerë se ç’mendohej.

Analiza sinkronike e sistemit fonologjik në dialektet e gjuhës shqipe është pjesa kryesore e punimit “Dialektet e gjuhës shqipe” dhe zë vendin qendror në monografi. Por autori i ka kushtuar vëmendje edhe studimit diakronik të tipareve kryesore dialektore që dallojnë dialektet e shqipes. Edhe këtu studimi përqendrohet në ndryshimet në sistemin fonologjik të dialekteve gjatë zhvillimit të tyre. Ky vështrim historik ka rëndësi për të shpjeguar gjendjen e sotme të sistemit fonetik të dialekteve si rezultat i zhvillimeve e lëvizjeve që ka pësuar në kohë.

Në vështirësinë e madhe që ka studimi i ndryshimeve fonetike në etapa të ndryshme të historisë së dialekteve të shqipes për shkak të mungesës së dokumentimit të saj, autori përcakton disa kritere e kufizime për studimin e tyre. Si pikënisje për krahasim merret një njësi ose një pjesë e sistemit e kohës kur ajo ka qenë e përbashkët për mbarë gjuhën. Si fazë e përbashkët e gjuhës merret periodha pas formimit të gjuhës së sotme shqipe. Për çdo ndryshim fonetik jepet lloji, karakteri, pikënisja e pikëmbërritja e tij. Më pas analizohen rrugët dhe shkaqet e ndryshimeve, kryesisht kushtet fonetike apo mjedisi tingullor që rrethon fonemën që i nënshtrohet ndryshimit ose pozicioni i saj brenda fjalës, dhe shpjegohen proceset fiziologjike që ndodhin gjatë shqiptimit të këtyre sekuencave tingullore. Edhe në këtë analizë diakronike zbatohet metoda strukturore-funksionale, sipas së cilës ndryshimet fonetike shihen në aspektin funksional duke përcaktuar vlerën e tyre fonologjike, proceset e fonologjizimit dhe të defonologjizimit dhe pasojat e tyre në inventarin e fonemave në dialekte, zëvendësimin e fonemave (Lautsubstitution) duke ndjekur tërë procesin që zhvillohet në këtë rast, që nga procesi fonetik, krijimi i varianteve të fonemave, e deri te procesi i

fonologjizimit të varianteve fonetike. Ndryshimet fonetike shihen në sistem, duke ndjekur shkallë-shkallë në lidhje e varësi të ndërsjellë pasojat zinxhir që sjell një ndryshim në një pikë të sistemit të një dialekti, një të folmeje apo grupi të folmesh.

Vëmendja e studimit është përqendruar në disa nga dukuritë fonetike dialektore më të rëndësishme që kanë ndodhur në historinë e gjuhës shqipe. Këto dukuri që janë marrë në shqyrtim në punim dhe që kanë qenë edhe më parë objekt i interesit shkencor të autorit, janë: opozicioni zanore hundore në gegërisht dhe /ë/ e theksuar në toskërisht, opozicioni i zanoreve sipas gjatësisë, zanoret e theksuara /i/ dhe /y/, togjet e zanoreve /ua/, /ye/, /ie/, rotacizmi në toskërishte, bashkëtingëlloret qiellzore /q/ e /gj/, grupet e bashkëtingëlloreve /kl/ /gl/ dhe disa dukuri të tjera fonetike që kanë ndodhur në disa grupe bashkëtingëllore të shqipes gjatë historisë së saj.

Mund të themi se studimi mbi zanoret hundore të gegërishtes dhe dukuria gjegjëse e saj në toskërishte, /ë/ e theksuar, është studimi më i thelluar e më i plotë për këtë çështje, nga më të vështirat e fonetikës historike të shqipes, i kryer sipas metodës strukturore. Studimi nis nga paraqitja e gjendjes së sotme të këtyre dukurive në të dy kryedialektet e shqipes: të zanoreve hundore në dialektin e veriut, me dallimet që kanë të folmet e ndryshme të gegërishtes nga njëra-tjetra, dhe të gjendjes së zanores /ë/ në të folmet e toskërishtes, për të kaluar në lidhjet e tyre historike e etimologjike, në kronologjinë relative të dukurisë së hundorëzimit, në rindërtimin e proceseve fiziologjike që kanë përshkruar zanoret hundore në kontekstet e caktuara fonetike deri në shndërrimin në fonemën /ë/ me variantet fonetike të saj në të folmet e toskërishtes. Studimi vështrohet edhe shtrirjen historike të zanores /ë/ në drejtimin jugperëndim-verilindje, duke vënë në dukje lidhjet e saj me gjuhët e tjera ballkanike, si një nga dukuritë tipike të lidhjes gjuhësore ballkanike, që pas gjithë gjasash e ka burimin e saj nga shqipja, si “gjuha e elementit etnik të Ballkanit të lashtë” (Gjinari 1989, 200).

Në shpjegimin dukurisë së rotacizmit në shqipe vlen të përmenden shkaqet e kësaj dukurie të toskërishtes. Autori e sheh në një plan më të gjerë idenë e Pedersenit për shqiptimin e labërguar të /n/-së në shqipe dhe e shtrin deri te dukuria e rënies së bashkëtingëlloreve të zëshme ndërzanore ose në fund të fjalës, pra e sheh si një veti të shqipes për shqiptim të dobët të këtyre bashkëtingëlloreve, gjë që vihet re edhe sot nga analizat laboratorike.

Sa për mendimin e ndonjë sllavisti, si Vaclav Polaku, se rotacizmi ka ndodhur pas ardhjes së elementit shqiptar në Shqipërinë e Jugut mbi një shtresë sllave dhe është pasojë e shqiptimit sllav të /n/ kakuminalë të shqipes, kjo tezë hidhet poshtë me argumente të qëndrueshme nga historia e gjuhës shqipe për kronologjinë relative të rotacizmit si dukuri që ishte në shuarje në

kohën e ardhjes së sllavëve në Shqipëri, dhe nga analizat e fonetikës eksperimentale që provojnë se /n/ e shqipes nuk është kakuminale.

Tezës së Vaclav Polakut mbi ndarjen në dy dialekte të shqipes si rezultat i veprimit të dyfishtë të substratit sllav: bullgarishtes në Jug dhe serbishtes në Veri, autori i ka kushtuar vëmendje të posaçme në punim, duke mbajtur qëndrim kritik ndaj çështjeve të ndryshme që sillen në mbështetje të kësaj teze. Argumentet në kundërshtim të kësaj teze mbështeten në të dhënat e historisë së gjuhës shqipe e të gramatikës historike të shqipes që i shohin si zhvillime të brendshme të shqipes dallimet dialektore që u vishen ndikimeve të gjuhëve fqinjë. Në këto çështje punimi jep kontribute të rëndësishme edhe në fushën e historisë së gjuhës shqipe e të historisë së dialekteve të saj.

Në historinë e degëzimit dialektor të shqipes përdoret metoda e rindërtimit të brendshëm, duke u nisur nga veçoritë më të reja dialektore duke shkuar shkallë-shkallë deri tek më të vjetrat për të rindërtuar sa të jetë e mundur gjendjen e dialekteve në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre. Tiparet dialektore shihen të ndërlidhura dhe në sistem dhe në këtë mënyrë ato ndihmojnë për shpjegimin e njëra-tjetrës. Aty ku ka të dhëna shkrimore shfrytëzohen edhe këto dhe, bashkë me të dhënat nga historia e popullit, shërbejnë për vendosjen e një kronologjie relative të lindjes së tipareve të ndryshme dialektore dhe rrethanave të tyre. Studimi i gërshtuar i të dhënave gjuhësore e historike, i zhvillimeve të brendshme të gjuhës shqipe dhe i ndikimeve nga gjuhët e tjera, vështrimi në thellësi e në imtësi i veçorive dalluese dialektore që nga dialektet kryesore e deri tek të folmet e veçanta, përpjekja për shtresëzimin kronologjik të tyre, e kanë ndihmuar autorin të ndriçojë rrethanat dhe shkaqet e ndryshimeve dialektore në kohë dhe hapësirë.

Studimi përballet edhe me çështjen e ndërlikuar e të pazgjidhur ende përfundimisht të lashtësisë së ndarjes dialektore të shqipes. Kjo është një nga përpjekjet e rralla në gjuhësinë shqiptare për një vështrim ndërdisiplinor të ndryshimit dialektor të lidhur me historinë e popullit. Në këtë krye të punimit ndërthuren aspektet historiko-shoqërore, elementet antropologjike e etnografike me ato gjuhësore për të dhënë një tablo të përgjithshme por mjaft të saktë të proceseve historike që ndikuan në jetën e popullit tonë, të faktorëve konvergues e divergues në krijimin e dialekteve, të lëvizjeve demografike dhe rrethanave historike të lindjes ose zhdukjes së tipareve të veçanta dialektore, për të ardhur deri në gjendjen e sotme të ndarjes së dialekteve të shqipes me tiparet kryesore dalluese, mbështetur edhe nga të dhënat e kulturës materiale e shpirtërore.

Vepra i kushton vëmendje, në një krye të veçantë, marrëdhëniet e dialekteve me gjuhën letrare në kohën e sotme. Aty theksohet fakti se gjuha letrare është një variant i ri i gjuhës së përbashkët, ajo ngrihet mbi dialektet dhe formon një sistem të vetin, i cili hyn në marrëdhënie me dialektet, duke

marrë prej tyre e duke dhënë tek to. Pasi është formuar, gjuha letrare vepron fuqishëm mbi dialektet për afrimin e tyre me njëri-tjetrin e me vetë gjuhën letrare, dhe nga ana tjetër dialektet ndikojnë mbi gjuhën letrare duke e pasuruar atë. Studimi ndalet në procesin e formimit të gjuhës letrare duke vënë në dukje çfarë ka marrë gjuha letrare nga variantet dialektore dhe e ka ngritur në normë dhe çfarë ka lënë mënjanë. Autori thekson se në “zgjedhjen” e varianteve normative, përveç faktorëve gjuhësorë, ndikojnë në mënyrë vendimtare faktorët jashtëgjuhësorë ose politiko-shoqërorë, të cilët ndryshojnë për gjuhë letrare të ndryshme.

Studimi i raporteve gjuhë letrare-dialekt nga autori ka vijuar edhe mbas përfundimit të këtij punimi dhe është paraqitur në mënyrë të plotë në veprën më të re të botuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike.

Në këtë vështrim, siç e theksuam në fillim, vepra “Dialektet e gjuhës shqipe” është një sintezë për kohën kur përfundoi së shkruari. Puna kërkimore-shkencore e Jorgji Gjinarit vijoi më tej me projektin madhor të *Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe*, me hartimin e Parimeve themelore të tij, me drejtimin e krejt punës së grupit hartues të dialektologëve deri në përfundimin me sukses të kësaj vepre gjigante të gjuhës shqipe. Ajo vijon edhe sot nga profesori ynë i nderuar, dhe ne i urojmë jetë të gjatë e shëndet për të punuar sa t’i dojë zemra.

SUMMARY

“DIALEKTET E GJUHËS SHQIPE” – SYNTHESIS OF SCIENTIFIC AND RESEARCH WORK OF JORGJI GJINARI

The article treats the contribution of prof. Jorgji Gjinari, one of the most prominent Albanian dialectologists in the study of Albanian dialects, focusing on his major work “The dialects of Albanian language”.

After emphasizing his contribution in the descriptive study of several Albanian varieties, either from Gheg or Tosk dialect, as well as his merit in defining the division of Albanian dialects, the article focuses in the second phase of the Albanian dialectological studies, related to the need to further expand the study in two directions: on the one hand, to explain the reasons for specific dialectal phenomena and on the other hand, to achieve a greater generalization of dialect phenomena in order to highlight the common features of Albanian dialects and to bring forth the unity of the Albanian language.

This is the claim that Jorgji Gjinari supports in his work “The dialects of Albanian language” published in 1989. This work was a state-of-the-art of

the work carried out to date on the Albanian dialectology research not only by the author himself but also by other dialectologists.

This work marked a qualitative leap in the study of Albanian dialects, because it implemented a new method in the field of synchronic studies of Albanian, the structural-functional method of the Prague School, which began to be utilized in Albania in the 70s. According to this method, in the course of the study, every dialectal phonetic feature is viewed within the language system and analyzed for their structural and functional aspects, by considering their functional value within the respective dialectal systems. The author has also applied the same structuralist method to the study of the morphological differences of Albanian dialects, which remains a pioneer work in our grammatical studies.

The author has also paid attention to the diachronic study of the main dialectal features that differentiate Albanian dialects. The study focuses on some of the more important dialectal phonetic phenomena that have occurred in the history of the Albanian language, such as the opposition of nasal vowel in Gheg vs accentuated /ë/ in Tosk, the opposition of the vowel after their length, the accentuated vowels /i/ and /y/, the vowel clusters /ua/, /ye/, /ie/, the rhotacism in Tosk, the palatal consonants /q/ and /gj/, the consonant clusters /kl/ /gl/ and some other historical phonetic phenomena in consonant clusters in Albanian.

The study also tackles the tricky and still unresolved issue of the origin of the division of Albanian dialects. This is one of the rare attempts in Albanian linguistics that provides an interdisciplinary view of the dialectal change associated with the history of the people.

